



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 14 shtator 2018, në orën:11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Valon Ramadani, Adem Mikullovc, Imet Rrahmani, Arban Abrashi, Xhevahire Izma, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Shqipe Pantina dhe Jasmina Zhivković.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e KPM-së, RTK-së, Ambasadës Amerikane, Kujtesa dhe deputeti Salih Zyba.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

**Rend i ditës:**

1. Takimi i Komisionit me përfaqësuesit e KPM- së, RTK- së dhe FFK-së, me temën: Shitja e të drejtave mediale nga UEFA në territorin e Republikës së Kosovës, nëpërmjet thirrjes për Ofertim në territorin e Serbisë.

**Nait Hasani**, njoftoi komisionin, se arsyeja e shqyrtimit të çështjes është shqyrtimi i ankesave të operatorëve për dëmet që iu janë shkaktuar për blerjen e transmetimit nga Serbia. Kosova, si shtet i pavarur, ka të drejtën për transmetim të drejtpërdrejtë, shitja e të drejtave nga UEFA në territorin e Kosovës përmjet thirrjes për ofertim nga Serbia, ka shkaktuar dëm operatorëve të Kosovës, ngase UEFA ka lëshuar dy të drejta, të drejtën që transmetimi të jepet nga Serbia për Kosovë dhe tjetrën të drejtë, drejtpërdrejt për Kosovën.

Lidhur me këtë, ai kërkoi sqarime nga KPM-ja dhe pyeti se çka duhet të vepohet që kjo e drejtë të mos i cenohet Kosovës?

**Muja Ferati**, kryetar i KPM-së, konfirmoi se KPM-ja ka pranuar ankesën e Kujtesa-net kundër operatorit ART-motion lidhur me transmetimin e ndeshjes futbollistike, nëpërmjet të ARENA Sport-TV, e drejtë kjo e siguruar nga Telekom i Serbisë dhe e fituar me tender në vitin 2017. Lidhur me këtë KPM në kuadër të kompetencave që ka verifikon validitetin e marrëveshjes për të drejtën që ka ose që nuk i takon sipas marrëveshjes për transmetim.

**Nait Hasani** pyeti nëse një herë i është dhënë e drejta Serbisë, pse është hapur tenderi i dytë për një të drejtë me të cilën janë dëmtuar kompanitë e Kosovës.

- Si ka mundësi t'i jepet e drejta për transmetim nga UEFA sipas marrëveshjes së vitit 2017 dhe 2018, ndërsa që UEFA e ka pranuar Kosovën si shtet në vitin 2016?

- A është shkelje e Kushtetutës së Kosovës marrja e të drejtës nga Serbia e ART-motion, në kontekstin e marrjes së të drejtës nga Serbia për transmetimin edhe për Kosovën?

**Milaim Zeka** kërkoi nga KPM-ja të shqyrtohet çështja e të drejtës së ART-motion dhe komisioni të vendosë se çështja në fjalë a është e drejtë apo shkelje.

**Xhevahire Izmaku**, duke shpreh pakënaqësinë me punën e KPM-së, tha se do të vlerësohet performanca dhe pavarësia e KPM-së.

**Imet Rrahmani** pyeti, sa është respektuar sovraniteti dhe infrastruktura ligjore e Kosovës?

**Arban Abrashi** pyeti me hapjen e tenderit a kanë qenë të njoftuara të gjitha kompanitë?

**Salih Zyba** pyeti a janë paraparë shkeljet të cilat tani janë evidente, nga KPM-ja?

**Valon Ramadani**, kërkoi, që t'i dërgohet notë proteste UEFA-s dhe ART-motion t'i ndërpritet licenca.

**Milaim Zeka** tha se tenderi ka qenë në rregull juridikisht. N tender kanë aplikuar edhe kompanitë e tjera kosovare, duke propozuar që të shikohet dosja e tenderit para se të merret vendim nga komisioni.

Vlerësimi i tij ishte, se KPM ka bërë shkelje duke lejuar kompanitë e tjera të transmetojnë sport me të drejtat e blera nga Serbia.

**Nait Hasani**, kërkoi nga KPM-ja, me mbështetjen e komisionit, që të kërkohet përgjigje nga UEFA dhe varësisht nga përgjigjja të sanksionohet shkelja dhe të korrigjohet veprimi.

Kërkojmë përgjegjësi, në konsiderim se është shkelur kushtetuta e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën:11:15.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i Komisionit,**

-----

**Nait Hasani**